

RADIO
TELEVISIONI
SHQIPTAR

KESHILLI DREJTUES I RTSH
NR. 1495 PROT

Tirane me 22.05.2020

VENDIM
Nr. 20, Datë 22.05.2020

Në zbatim të nenit 102 pikat 2/ç të ligjit nr 97/2013, datë 04.03.2013 “ Për median audiovizive ne RSH”, nenit 17 të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr 98, datë 22.12.2016 “ Për miratimin e Statutit të RTSH”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH me shkresën nr 1461 prot, date 21.05.2020, mbi disa ndryshime në Strukturën Organizative të Njesisë së Programeve të RTSH-së, Këshilli Drejtues i RTSH në mbledhjen e tij të datës 22.05.2020, me votimin pro të 6 anëtarëve të pranishëm K.Traja, S.Kumbaro, H.Haliti, A.Shegani, XH.Mato, dhe Xh.Aliu;

VENDOSI:

I. Të miratojë disa ndryshime në Strukturën Organizative të Njesisë së Programeve të RTSH-së, si më poshtë vijon:


NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE

- Të shtohet Struktura e Kanalit RTSH Shkollë me 4 (katër) vende pune si më poshtë:
 - 1 (një) vend pune me emërtesën “Redaktor përgjegjës”
 - 1 (një) vend pune me emërtesën “Kordinator”
 - 2 (dy) vende pune me emërtesën “Redaktor”
- Të shkurtohet 1 (një) vend pune në emërtesën “Redaktor” në RTSH1 në Njësinë e Programeve të RTSH.
- Të shkurtohet 1 (një) vend pune në emërtesën “Redaktor” në RTSH3 në Njësinë e Programeve të RTSH.
- Të shkurtohet 1 (një) vendpune në emërtesën “Kordinator” në RTSH Film, Dokumentar & Shqip në Njësinë e Programeve të RTSH.
- Të shkurtohet 1 (një) vend pune në emërtesën “Regjisor” në Sektorin e Rivitalizimit & Rivitalizimit të RTSH në Njësinë e Programeve të RTSH.

Address: "Ismail Qemali" Street, No.11, Tirana, Albania

Phone: + 355 4 22 27 512
Fax: + 355 4 22 27 745
e-mail: info@rtsh.al

www.rtsh.al



RADIO
TELEVIZIONI
SHQIPTAR

Numri i vendeve të punës në Strukturën Organizative të Njësisë së Programeve të RTSH-së për vitin 2020 nuk ndryshon, mbetet 90.

II. Ky vendim hyn në fuqi një datë 01.06.2020.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH

Kristaq TRAJA

Address: "Ismail Qemali" Street, No.11, Tirana, Albania

Phone: + 355 4 22 27 512
Fax: + 355 4 22 27 745
e-mail: info@rtsh.al

www.rtsh.al

